

KNF - Kredia për NMVM-të II - Banka për Biznes (BpB)

Vendi:	KOSOVË
ID-ja e projektit:	56760
Sektori i biznesit:	Kredit depozitues (bankat)
Lloji i njoftimit:	PRIVAT
Kategoria mjedisore:	IF
Data e aprovimit:	19 gusht 2025
Statusi:	Në fazën e hulumtimit, në pritje të shqyrtimit përfundimtar
Data e publikimit në anglisht:	19 gusht 2025

Sipas nenit 1.4.2 (iii) të Direktivës për Qasje në Informata: "Për projektet e aprovuara nga menaxhmenti i Bankës, kur Bordi i Drejtorëve e ka deleguar autorizimin për aprovim, DSP-ja do t'i zbulohet një vendi anëtar të Bankës në fillim të periudhës relevante të njoftimit pa kundërshtime, sipas nenit 13 (iii) të Marrëveshjes për Themelimin e BERZh-it".

Përshkrimi i projektit

Një kredi e lartë e pasiguruar për NMVM-të deri në 10 milionë euro, sipas Kornizës së Ndërmjetësve Financiarë (KNF-së), për Bankën për Biznes (BpB-në), ku të ardhurat do të përdoren për kredidhënie të mëtejshme për NMVM-të në Kosovë, në përputhje me Deklaratën e Politikave të KNF-së. BpB-ja do të synojë t'i ndajë 50% të të ardhurave të kredisë për nënkredi të gjelbra, në përputhje me kriteret e përshtatshmërisë të Tranzicionit të Ekonomisë së Gjelbër (TEGj) të BERZh-it.

Objektivat e projektit

Projekti do t'i kontribuojë strategjisë së BpB-së për ta zgjeruar kredidhënien për segmentin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Përveç kësaj, banka do t'i rrisë investimet e gjelbra të saj, duke synuar t'i ndajë 50% të të ardhurave për projekte të përshtatshme për TEGj.

Ndikimi i tranzicionit

Rezultati i NTE-së: 60

Projekti u kontribuon objektivave të KNF-së, duke i mbështetur cilësitë e ndikimit të tranzicionit **konkurrues** dhe **të qëndrueshëm**

Konkurrues: Projekti do t'i kontribuojë ndërtimit të një sektori financiar më konkurrues, duke e avancuar kredidhënien e BpB-së për ndërmarrjet private të vogla dhe të mesme në Kosovë, me fokus në shtrirjen rajonale dhe tërheqjen e klientëve të rinj.

I qëndrueshëm: Projekti do t'i kontribuojë qëndrueshmërisë së sektorit financiar, duke siguruar praktika të kredidhënies së kujdesshme dhe cilësi të përshtatshme të portofolit.

Informatat për klientin

BANKA PËR BIZNES Sh.A.

Banka për Biznes, Sh.A. ("BpB-ja") është institucion financiar partner (IFP) i BERZh-it që ekziston në Kosovë që nga viti 2010. Ajo e ofron një gamë të gjerë të produkteve bankare komerciale për të gjitha segmentet e klientëve, me fokus kryesor në mikroklientët, NVM-të dhe shitësit me pakicë. BpB-ja, e themeluar në vitin 2001, është banka e shtatë më e madhe në Kosovë në mesin e 11 kompanive që veprojnë në treg, me një hise të tregut prej 7% sipas gjithsej pasurive dhe kredive neto që nga viti 2024.

Përmbledhja e financimit nga BERZh-i

10,000,000.00 euro

Gjithsej kostoja e projektit

10,000,000.00 euro

Shtesa

Shtesa arrihet duke e zgjeruar financimin e nevojshëm afatgjatë në formë të një kredie të lartë që nuk është lehtësisht e disponueshme në tregun vendas.

Përmbledhja mjedisore dhe sociale

Kategorizohet si IF (PMS 2024). BpB-ja, një klient ekzistues, ka demonstruar pajtueshmëri të vazhdueshme me Kërkesat e Performancës 2, 4 dhe 9 të Bankës, sipas Politikës Mjedisore dhe Sociale (PMS-së) të vitit 2019. Për këtë projekt, nënprojektet e përshtatshme do ta financojnë kredidhënien e mëtejshme për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat ka të ngjarë të paraqesin rreziqe të

ulëta mjedisore dhe sociale (M&S), për shkak të madhësive të vogla të kredive. Vlerësimi i duhur mjedisor dhe social është bërë duke e rishikuar pyetësorin mjedisor dhe social që e ka plotësuar klienti. BpB-ja e ka një sistem të menaxhimit mjedisor dhe social (SMMS) që konsiderohet se është në përputhje me profilin e riskut të nënprojekteve të përshtatshme. Pritet që BpB-ja t'u përmbahet udhëzimeve të BERZh-it për sa u përket kredive për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme si dhe korporatat dhe t'i përmbushë kërkesat mjedisore dhe sociale 2, 4 dhe 9 sipas PMS-së së vitit 2024, duke përfshirë edhe respektimin e Listës së Përgjashtimeve të BERZh-it të vitit 2024. Krahas kësaj, nënkredimarrësit që financohen përmes kredive të BpB-së duhet t'i zbatojnë rregulloret kombëtare në fuqi për mjedisin, shëndetësinë, sigurinë dhe punën. Nëse financimi i BERZh-it përdoret për nënprojekte solare, të cilat mund të mbartin rreze të mëdha të punës në zinxhirin e furnizimit, këto nënprojekte duhet të menaxhohen duke iu përmbajtur Deklaratës së Politikave të BERZh-it. Sipas PMS-së së vitit 2024, nga BpB-ja gjithashtu kërkohet që t'i shpalosë publikisht informatat për SMMS-në e saj.

Vlerësimet e gjelbra

Projekti është përcaktuar në përputhje me Marrëveshjen e Parisit, duke u bazuar në aplikimin e qasjes së përafrimit të Parisit të BERZh-it për investimet e financuara në mënyrë të tërthortë. Vendimi për përafrim bazohet në aplikimin e shtyllës 1 (përkushtimi i palës homologe ndaj Marrëveshjes së Parisit) dhe shtyllës 2 (filtri i nëntransaksioneve). 50% e financimit të BERZh-it klasifikohet si financim i gjelbër, meqë i mbështet aktivitetet për arritjen e zbutjes së ndryshimeve klimatike. Ky atribut përcaktohet sipas metodologjisë së përcaktimit të atributit si financim i gjelbër për investimet e BERZh-it.

Bashkëpunimi teknik dhe financimi i granteve

Të dhënat kontaktuese të kompanisë

Argjira Kadrijaj Dushi

argjira.kadrijaj@bpbbank.com

+383 49 904 892

www.bpbbank.com

Rr. Ukshin Hoti, Nr. 128, Prishtinë 10000, Kosovë

DSP për herë të fundit është përditësuar më:

19 gusht 2025

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efektive për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.

